VENDIM
Nr.1081, datë 29.12.2010

PËR PËRZGJEDHJEN E KOMPANISË AUSTRIAKE QË DO TË PËRGATITË PROJEKTIN E FISIBILITETIT NË LIDHJE ME PROJEKTET NË FUSHËN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, QË DO TË FINANCOHEN NË KUADËR TË BASHKËPUNIMIT FINANCIAR ME AUSTRINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 26 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të përzgjedhë kompaninë austriake që do të përgatitë projektin e fisibilitetit, si dhe të paguajë koston lokale të vlerës përkatëse të këtij projekti, për identifikimin e projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe të qeverisjes elektronike, që do të financohen në kuadër të bashkëpunimit financiar me Austrinë.

2. Përzgjedhja do të bëhet sipas procedurave të përcaktuara në letërkëmbimin ndërmjet AKSHI-t dhe palës austriake.

3. Ngarkohen Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha